



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 20.11.2018

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

PËR

SHQYRTIMIN NË PARIM TË PROJEKTLIGJIT “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008, “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet datave 6.11.2018; 8.11.2018 dhe 20.11.2018, mori në shqyrtim në parim, projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 dhe 78-84 të Rregullores së Kuvendit.

Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, dhe 155,

të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, ka si qëllim unifikimin e tarifës doganore, për të gjitha nën kodet në nivel tetë shifror të Kreut 8418 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, që i përkasin artikullit “njësi frigoriferike” me synim krijimin e një konkurrence të drejtë për të gjithë importuesit që trajtojnë këto artikuj.

Në mënyrë më të detajuar parashikimet e këtij projektligji konsistojnë në një ndryshim në lidhjen nr. 1 të ligjit nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, konkretisht ndryshimin e nivelit të tarifës doganore nga 2% në 10%, për 4 kode (8418 10 20; 8418 10 80; 8418 30 20 dhe 8418 30 80) të Kreun 8418, të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave që përfaqësojnë ftohësit/ngrirësat e kombinuar, të përshtatura me dyer të jashtme të veçanta, me kapacitet mbi 340 litra dhe të tjera si dhe ftohës/ngrirësat e kombinuar, të përshtatura me dyer të jashtme të veçanta, me kapacitet deri 400 litra si dhe me kapacitet mbi 400 litra por deri 800 litra.

Sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në Kreun 8418, në nivel 8 shifror, përfshihen 20 kode tarifoze nga të cilët 4 prej tyre kanë tarifë doganore 2%, ndërsa kodet e tjera, kanë tarifë doganore 10%.

IV. Efekti financiar

Unifikimi i tarifës vlerësohet se sjell një efekt pozitiv në buxhet në masën 50 milionë lekë.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, bëri një prezantim të parashikimeve dhe ndryshimeve që propozon ky projektligj, me synim unifikimin e tarifës për këtë Kre të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, çfarë do të ndikojë në frenimin e deklarimeve jo të sakta nga operatorët ekonomik për të përfituar padrejtësisht tarifën më të ulët.

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, e miratoi në parim projektligjin, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

Ervin BUSHATI

KRYETAR

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 27.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË
8.9.2008, “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË
NDRYSHUAR
(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 26 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar. Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projektbuxhetin 2019.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 si dhe nenet 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 26 nëntor ishin të pranishëm përfaqësues nga shoqatat e biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri, *Dhoma Gjermane e Tregtisë* dhe Industrisë në Shqipëri dhe Biznes Albania. Ndërsa, në mbledhjen e datës 27 nëntor ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Projektligji ka si qëllim unifikimin e tarifës doganore, për të gjitha nën kodet në nivel tetë shifror të Kreut 8418 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, që i përkasin artikullit “njësi frigoriferike” me synim krijimin e një konkurrence të drejtë për të gjithë importuesit që trajtojnë këto artikuj.

Në mënyrë më të detajuar parashikimet e këtij projektligji konsistojnë në një ndryshim në lidhjen nr. 1 të ligjit nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, konkretisht ndryshimin e nivelit të tarifës doganore nga 2% në 10%, për 4 kode të Kreut 8418, të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave që përfaqësojnë ftohësit/ngrirësat e kombinuar, të përshtatura me dyer të jashtme të veçanta, me kapacitet mbi 340 litra dhe të tjera si dhe ftohës/ngrirësat e kombinuar, të përshtatura me dyer të jashtme të veçanta, me kapacitet deri 400 litra si dhe me kapacitet mbi 400 litra por deri 800 litra.

Sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, në Kreun 8418, në nivel 8 shifror, përfshihen 20 kode tarifore nga të cilët 4 prej tyre kanë tarifë doganore 2%, ndërsa kodet e tjera, kanë tarifë doganore 10%.

Unifikimi i tarifës vlerësohet se sjell një efekt pozitiv në buxhet në masën 50 milionë lekë.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi me 10 vota pro dhe një votë kundër.

RELATOR

KRYETARI

Ervin BUSHATI

Erjon BRAÇE